

## Terma Reference

### Thirrje për konsulent për komunikimin

<b>Konsulencë</b>	Thirrje për konsulent për komunikimin
<b>Kohezgjatja e shërbimit</b>	Mars - Prill 2025
<b>Zona e projektit</b>	Bashkia Korçë dhe Durrës
<b>Data e mundshme e fillimit të punës</b>	01 Prill 2025

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS kërkon të kontrakttojë një konsulent për komunikimin, për të realizuar një plan komunikimi si dhe për të zbatuar mbështetur fushatat e ndërgjegjësimit në Bashkinë Korçë dhe Durrës, në kuadër të programit Bashkimi Evropian për Kujdesin Social (EU4SocialCare) i financuar nga BE dhe i zbatuar nga UNICEF Albania dhe ëorld Vision Albania.

Kjo konsulencë do të ofrohet në mbështetje të Bashkisë Korçë dhe Durrës, Drejtorisë së Kujdesit Social, Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen dhe Nisma ARSIS për zhvillimin dhe zbatimin e strategjive të komunikimit për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të promovuar programin për mbështetjen e fëmijëve dhe familjes. Ky rol përfshin hartimin e materialeve informuese, menaxhimin e kanaleve të komunikimit dhe mbështetjen e aktiviteteve advokuese për të siguruar që mesazhet e programit të jenë të qarta, efektive dhe të arrijnë audiencën e synuar.

#### **Rreth Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS**

**Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS** (shkurtimisht NISMA ARSIS) është një organizatë jofitimprurëse, e cila është themeluar në shkurt të vitit 2016. NISMA ARSIS është një aktor jo qeveritar me influencë në sektorin e shoqërisë civile në Shqipëri.

Misioni i NISMA ARSIS është angazhimi për avancimin e të drejtave të fëmijëve, të rinjve dhe familjarëve të tyre që përballen me vulnerabilitet, duke ofruar shërbime gjithëpërfshirëse dhe duke lehtësuar integrimin me dinjtet e tyre në shoqëri. NISMA ARSIS advokon dhe lobon në nivel lokal dhe qëndror mbi çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve, zhvillimit dhe pjesëmarrjes, përmirësimit të kushteve social-ekonomike të familjeve të tyre dhe fuqizimit të kapaciteteve të shërbim ofruesve, organizatave jofitimprurëse, profesionistëve dhe aktorëve të tjerë të cilët punojnë me fëmijët në situatë vulnerabël.

#### **Përshkrimi i Projektit**

Projekti po zbatohet në Bashkinë Korçë “Forcimi i krijimit dhe ofrimit të shërbimeve të kujdesit social për të mbrojtur fëmijët dhe komunitetet vulnerabël në Bashkinë e Korçës dhe Durrësit” në kuadër të programit Bashkimi Evropian për Kujdesin Social (EU4SocialCare) i financuar nga BE dhe i zbatuar nga UNICEF Albania dhe ëorld Vision Albania. Metodologjia e propozuar bazohet në parimet e Konventës për të Drejtat e Fëmijës (CRC), standardeve ndërkombëtare të kujdesit alternativ për fëmijët dhe prioritetet kombëtare, duke përfshirë programin e Qeverisë së Shqipërisë, i cili synon të avancojë një sistem të mbrojtjes sociale gjithëpërfshirës dhe të përgjegjshëm për të mbështetur individët gjatë gjithë ciklit të jetës. Ajo përdor një model socio-ekologjik që vendos fëmijën në qendër të të gjitha ndërhyrjeve, i rrethuar nga katër shtresa kryesore: kujdestarët/familja, komuniteti, kultura dhe shoqëria, si dhe mjedisi më i gjerë/politikat.

Nën mbështetjen dhe bashkëpunimin me ekipin koordinues të programit, **Konsulenti për komunikimin, do të ketë këto deyra dhe përgjegjësi:**

- Zhvillon dhe zbaton planin e komunikimit për programin, duke përfshirë planin e komunikimit dhe aktivitetet mediatike.
- Krijon dhe menaxhon përmbajtje për faqen e internetit, rrjetet sociale dhe platformat e tjera të komunikimit.
- Harton dhe redakton materiale promovuese si fletëpalosje, postera, raporte dhe buletine informuese.
- Mbështet organizimin e eventeve dhe fushatave të ndërgjegjësimit në nivel komunitar dhe institucional.
- Përgatit njoftime për shtyp, intervista dhe histori sukcesi për programin.
- Siguron që të gjitha komunikimet të jenë në përputhje me vizionin dhe vlerat e organizatës dhe të programit.
- Mbledh dhe analizon të dhëna mbi ndikimin e aktiviteteve të komunikimit dhe përgatit raporte mbi rezultatet.
- Koordinon me ekipin e projektit dhe partnerët për të siguruar përputhshmërinë e mesazheve dhe aktiviteteve të komunikimit.

#### ***Kualifikimet dhe aftësitë e kërkuara:***

- Diplomë në Komunikim, Marrëdhënie me Publikun, Gazetari, Shkenca Sociale ose fusha të ngjashme.
- Përvojë e mëparshme në një rol të ngjashëm, veçanërisht në organizata joqeveritare ose në sektorin social.
- Aftësi të shkëlqyera në shkrim, redaktim dhe krijimin e përmbajtjes.
- Përvojë në menaxhimin e rrjeteve sociale dhe platformave të komunikimit.
- Aftësi të mira në menaxhimin e marrëdhënieve me mediat dhe palët e interesit.
- Njohuri të mira mbi strategjitë e komunikimit për kauza sociale dhe ndërgjegjësim publik.
- Aftësi të shkëlqyera organizative dhe të punës në grup.
- Njohuri të mira të gjuhës angleze (e preferuar).

***Politikat e Mbrojtjes së Fëmijëve:*** Të gjithë personat që punojnë me programet e Nisma ARSIS janë të detyruar të respektojnë politikat e mbrojtjes së fëmijëve, politikat e mbrojtjes nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, rregulloren e brendshme të Nisma ARSIS, kodin e sjelljes, Legjislacionin e plotë për Mbrojtjen e Fëmijëve si dhe çdo dokument tjetër për të cilin duhet të ketë dijeni.

***Koha e mundshme e fillimit të punës është 1 prill 2025.***

***Kohëzgjatja e ofrimit të shërbimit është përgjatë periudhës prill 2025 mars 2026.***

***Kjo ekspertizë përfshin 96 ditë pune.***

#### ***Procedura e aplikimit:***

Aplikantët e interesuar për të aplikuar për këtë thirrje duhet të dërgojnë me email :

1. CV-në;
2. Letër interesi;
3. Letër angazhimi/disponueshmërie;
4. Ofertën financiare.

brenda dates **19 mars 2025** në [info@nisma-arsis.org](mailto:info@nisma-arsis.org) , ose me postë në adresën: Rruga "Sali Butka", Pallati T.B.M, Shkalla 2, Apartamenti 1, Kati 1, Njesia Bashkiake Nr.7, PC 1023, Tirana Albania.

#### **Procedura e Vlerësimit:**

Zgjedhja e ekspertit do të bazohet në:

- se sa mirë aplikimi përmbush kërkesat e përcaktuara në termat e referencës,
- eksperiencat e relevante të mëparshme
- oferta financiare
- gjithashtu edhe bazuar në tabelën e vlerësimit të mëposhtëm.

Kriteret e vlerësimit	Vlerat në %
Kualifikime	30%
Eksperiencë pune	50%
Oferta financiare	20%

*Ju lutemi, në vemendjen tuaj që:*

- në subjekt të emailit ose zarfit ku dërgohet aplikimi të vendoset: **Aplikim për thirrjen për për konsulent për komunikimin**
- vetëm personat e përzgjedhur për intervistë do të kontaktohen.